



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

Nr. i Dokumentit: 21.12;22X.11-2016-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**Procedurat dhe kontrollet në sistemin për menaxhimin e performancës
komunale**

Auditim i Performancës

Prishtinë, nëntor 2017

Auditori i Përgjithshëm, i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve të tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime të pavarura, objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë¹, efikasitetit² dhe efektivitetit³ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me këtë raport “Procedurat dhe kontrollet në Sistemin për menaxhimin e performancës komunale” në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme Vlorë Mehmeti, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që e ka realizuar këtë raport:

Mirlinda Ahmeti, Drejtor i Auditimit

Arben Selimi, Udhëheqës i ekipit

Fexhrie Thaqi dhe Elvin Mala, Anëtarë të ekipit

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT – Adresa: Musine Kokalari, Nr. 87, Prishtinë 10000, Kosovë

Tel: +381(0) 38 60 60/1011

<http://zka-rks.org>

¹ Ekonomia – Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së resurseve. Resurset e përdorura duhet të jenë në dispozicion me kohë, në sasi dhe cilësi të duhur dhe me çmimin më të mirë

² Efikasiteti – Parimi i efikasitetit nënkupton të marrësh maksimumin nga resurset në dispozicion. ka të bëjë me lidhshmërinë ndërmjet resurseve të angazhuara dhe rezultateve të dhëna në kuptim të sasisë, cilësisë dhe kohës.

³ Efektiviteti – Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritura.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	3
1 Hyrje.....	5
1.1 Problemi i auditimit.....	6
1.2 Objektivi i auditimit	7
1.3 Pyetjet dhe kriteret e auditimit	7
1.4 Fushëveprimi i auditimit	8
1.5 Metodologjia e auditimit	9
2 Përshkrimi i fushës së auditimit.....	10
2.1 Dokumentet relevante.....	10
2.2 Përshkrimi i SMPK	10
2.3 Palët e përfshira dhe mënyra e përfshirjes së tyre në zbatimin e SMPK	11
3 Të gjeturat kyçe.....	13
3.1 Krijimi i parakushteve të nevojshme nga MAPL për të siguruar funksionimin e duhur të SMPK-së	13
3.2 Krijimi i parakushteve të nevojshme nga Komunat për të siguruar funksionimin e duhur të SMPK-së	15
3.3 Më shumë detaje për secilën fushë të SMPK	19
4 Konkluzione	28
4.1 Krijimi i parakushteve të nevojshme nga MAPL për të siguruar funksionimin e duhur të SMPK-së	28
4.2 Krijimi i parakushteve të nevojshme nga komunat për të siguruar funksionimin e duhur të SMPK-së	29
5 Rekomandimet.....	30
Shtojca I: Tabela e treguesve	31

Lista e shkurtesave

MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
SEMPK	Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Performancës Komunale
SMPK	Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale
ZPR	Zyrtari Përgjegjës për Raportim
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
DEMOS	Projekti për Decentralizim dhe Përkrahje Komunave

Përmbledhje e përgjithshme

Ky raport paraqet vlerësimin që i është bërë mënyrës së funksionimit të Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale në përgjithësi, me fokus të veçantë në procedura dhe kontrolle për të konstatuar nëse sistemi prodhon të dhëna të besueshme dhe të sakta të mbështetura në dokumente. Që nga viti 2009, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka filluar zbatimin e Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale i cili ka adresuar performancën e komunave nga fushat e kompetencave vetanake. Matja e performancës së komunave ka për qëllim që vetë komunat, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, qytetarët dhe të gjitha palët e interesit ta kuptojnë se deri në çfarë shkalle komunat kanë arritur të ofrojnë shërbime në kohën dhe cilësinë e duhur, në funksion të përmirësimit të jetës së qytetarëve.

Për të realizuar këtë auditim janë përdorur metoda të ndryshme të hulumtimit. Janë hartuar pyetësorë me indikatorë të qartë, janë zhvilluar intervista dhe janë analizuar dokumentet relevante lidhur me objektivat e auditimit. Që të kemi rezultate të sakta të këtij auditimi ne kemi vlerësuar nëse udhëzuesit e punës janë përpiluar qartë dhe komunikuar tek të gjithë përdoruesit. Janë analizuar formularët e plotësuar të Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale për t'i krahasuar me burimin e të dhënave në të cilin janë mbështetur. Në teren janë ekzaminuar kontrollet në të gjitha nivelet e raportimit për të parë se si janë aplikuar, përderisa është vlerësuar mënyra se si koordinatorët komunal bëjnë verifikimin e të dhënave dhe nëse ato janë plotësuar përsëri pas vërejtjeve eventuale. Është analizuar dhe vlerësuar komunikimi, qarkullimi i informatave nga ofruesit e shërbimeve të ndryshme jashtë komunës tek drejtoritë relevante komunale dhe nga to tek zyrtarët komunal.

Janë audituar Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe gjashtë komuna të ndryshme për nga madhësia dhe përbërja etnike.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk kishte krijuar të gjitha parakushtet e nevojshme për funksionimin e Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale. Nuk kishte miratuar rregulloren e re dhe nuk e kishte hartuar procedurën për menaxhimin e ndryshimeve në sistem.

Gjatë auditimit në gjashtë komunat mostër, kemi konstatuar se komunat kanë vështirësi në aplikimin e procedurave dhe kontrolleve të parapara me sistem. Në komunat e audituara procedura e mbledhjes së të dhënave nuk ishte e duhura e po ashtu edhe kontrolli nga koordinatori komunal nuk kishte qenë efektiv. Të gjeturat tregojnë se probleme ka në mënyrën e mbledhjes, raportimit dhe verifikimit të të dhënave. Gjithashtu ka probleme lidhur me sigurimin e qasjes në të dhëna nga njësitë komunale. Si rrjedhojë e kësaj disa prej të dhënave të raportuara nuk ishin mbështetur në dokumente të fushave përkatëse, apo siç ishte përcaktuar nga metodologjia. Bazuar në të dhënat e raportuara në formularë, mund të argumentojmë se problemi aktual i procedurave jo të duhura dhe kontrollit jo efektiv është pasojë e mungesës së përkushtimit nga ana e zyrtarëve komunal të përfshirë në proces, meqë komunat nuk i kanë krijuar të gjitha parakushtet për funksionim të sistemit.

Ne rekomandojmë që Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal sa më parë të miratojë rregulloren e rishikuar për Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale aktuale dhe të hartojë një procedurë për menaxhim të ndryshimeve të sistemit e cila do të specifikojë qartë se kush është përgjegjës për inicimin, zhvillimin, aprovimin dhe zbatimin e ndryshimeve në sistem. Kjo për të evituar mangësitë që mund të lindin nga ndryshimet e mundshme të ardhme të sistemit.

Ndërsa Kryetarit të komunës i rekomandojmë që t'ua komunikojë të gjitha njësive organizative të komunës obligimin që ka komuna lidhur me procesin e raportimit për Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale në mënyrë që të jenë të përgatitura për të ofruar të dhënat e kërkuara. Po ashtu, i rekomandojmë që të sigurojnë bashkëpunim të ngushtë mes zyrtarëve përgjegjës për raportim dhe drejtorive komunale si dhe të sigurohet se koordinatori komunal dhe zyrtarët përgjegjës për raportim i kanë kuptuar drejtë procedurat e mbledhjes, raportimit dhe verifikimit të të dhënave si dhe të njëjtat i kanë ushtruar.

1 Hyrje

Qytetarët presin dhe meritojnë shërbime cilësore nga autoritetet e pushtetit lokal (komunat). I gjithë sistemi administrativ në Republikën e Kosovës parimisht është i ndërtuar që të jetë në funksion të qytetarëve. Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm. Disa prej fushave që lidhen me përgjegjësitë e komunave janë⁴:

- planifikimin urban dhe rural;
- mbrojtjen e mjedisit lokal;
- ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehjes lokale;
- përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;
- ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është
- përkujdes për të cënueshmit, strehimin familjar, përkujdes fëmijor, përkujdes për të moshuarit,
- shëndetësinë publike;
- ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike;
- aktivitetet kulturore dhe të lira etj.

Matja e performancës së komunave ka për qëllim që vetë komunat, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), qytetarët dhe të gjitha palët e interesit ta kuptojnë se deri në çfarë shkallë komunat kanë arritur të ofrojnë shërbime në kohën dhe cilësinë e duhur, në funksion të përmirësimit të jetës së qytetarëve.

Matja e performancës komunale po ashtu shërben si mjet i rëndësishëm për të përmirësuar lidhjen në mes të qeverisë qendrore dhe lokale dhe njëkohësisht mundëson angazhimin më të afërt në mes qeverive lokale dhe qytetarëve.⁵

Nga viti 2009 MAPL ka filluar zbatimin e Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK). Me mbështetjen e projektit USAID - EMI dhe pastaj USAID - DEMI, MAPL ka zhvilluar SMPK-në, i cili ka adresuar performancën e komunave nga fushat e kompetencave vetanake. Ndërtimi dhe funksionimi i sistemit është rregulluar me Rregulloren 02/2013 dhe janë dhënë udhëzimet themelore për funksionimin e sistemit me anën e një doracaku (MAPL -USAID 2013). Rishtazi MAPL ka hartuar **draft rregulloren nr. 02/2016** për SMPK e cila ende është në rishikim e sipër.

⁴ Ligji Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 17

⁵ Performance based grant system (PBGs), a guide for municipalities, July 2014

Indikatorët e performancës shpeshherë përfshijnë volumin, cilësinë, efikasitetin dhe rezultatet e ofrimit të shërbimeve të caktuara. Matja e performancës ka të bëjë me kulturën institucionale që vlerëson planifikimin, llogaridhënien, dhe shfrytëzimin e informatave në menaxhimin e organizatave publike dhe private.⁶

MAPL me përkrahjen e DEMOS-it ka iniciuar dhe filluar procedurat për krijimin dhe implementimin e Sistemit elektronik për menaxhimin e performancës komunale (SEMPK) me qëllim të vendosjes së të dhënave në sistem nga mënyra manuale në atë elektronike.

1.1 Problemi i auditimit

Komunat janë përgjegjëse për raportim të saktë dhe të plotë. Gjatë punës hulumtuese në fazën e planifikimit të auditimit kemi vërejtur se të dhënat e regjistruara në SMPK nuk mbështeten mjaftueshëm në dokumente e që mund të vijë si pasojë e:

- mungesës së stafit të kualifikuar;
- mungesës së kontrolleve dhe mbikëqyrjes; dhe
- mungesës së dokumentacionit/evidencave në drejtoritë përkatëse të komunave në të cilat do të mbështeteshin të dhënat e vendosura në sistem.

Në këtë konstatim kemi arritur përmes intervistave me një numër të kufizuar zyrtarësh nga niveli komunal dhe ai ministror si dhe me përfaqësuesit nga DEMOS. Për të pasur më të qartë se në çfarë aspektesh duhet orientuar këtë auditim ne kemi përpiluar një pyetësor për koordinatorët komunal lidhur me indikatorët të cilët ata i konsiderojnë si më të rëndësishëm dhe me vështirësitë të cilat ata i hasin gjatë punës së tyre me SMPK. Pyetësori është përcjellë tek tridhjetë e dy (32) komuna, që kanë përcaktuar koordinatorët për SMPK, nga të cilat na janë përgjigjur tetëmbëdhjetë (18).

Sipas këtij pyetësori vështirësitë më të theksuara kanë të bëjnë me:

- Pamundësinë për verifikimin e të dhënave;
- Mungesën e komunikimit respektivisht të ofrimit të të dhënave për fushat e caktuara nga drejtoritë përkatëse;
- Paqartësia në të kuptuarit e procedurave të punës;
- Baza jo e strukturuar e të dhënave;
- Definicionet; etj.

Që nga viti 2013 ZKA ka kryer auditime të performancës financiare në komuna. Raportet e dala nga këto auditime, të njohura si Dokument Diskutimi, janë diskutuar me palët e përfshira. Shqetësimi

⁶ International experience in Municipal Performance Measurement, Federation of Canadian municipalities, 2005

lidhur me besueshmërinë e të dhënave të raportuara nga komunat është ngritur në këto dokumente të publikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës.⁷

Bazuar në këta indikator konstatojmë se megjithëse MAPL në bashkëpunim me komunat kanë arritur të vendosin një sistem për menaxhimin e performancës komunale megjithatë ka mundësi të theksuara për përmirësim.

Ekziston rreziku që MAPL, si hallkë e fundit në proces që bën analizën e të gjitha të dhënave të pranuar nga komunat, mund të arrijë në konkluzione të gabuara për shkak mangësive të cekura më lartë.

1.2 Objektivi i auditimit

Objektivi i këtij auditimi është vlerësimi i mënyrës së funksionimit të SMPK në përgjithësi me fokus të veçantë në procedura dhe kontrolle për të konstatuar nëse sistemi prodhon të dhëna të besueshme dhe të sakta të bazuara në dokumente. Rekomandimet e dala nga ky raport i auditimit synojnë të ndikojnë në përmirësimin e mënyrës aktuale të funksionimit të SMPK.

1.3 Pyetjet dhe kriteret e auditimit

Pyetja kryesore e auditimit është formuluar krahas qëllimeve që i ka SMPK, dhe është parashtruar kështu:

A kanë ndërmarrë MAPL dhe komunat masa adekuate për të siguruar se sistemi prodhon të dhëna të besueshme dhe të sakta?

Pyetjet e auditimit

1. A janë krijuar parakushtet e nevojshme nga MAPL për të siguruar funksionimin e duhur të SMPK?

1.1. A ekziston rregullore për mënyrën e përdorimit të SMPK dhe procedura për menaxhimin e ndryshime e eventuale?

Kriteri: Përdorimi i SMPK duhet të jetë i bazuar në rregullore. Për çdo ndryshim që bëhet në SMPK duhet të ketë një procedurë që qartë e përkufizon se si iniciohet ndryshimi, nga kush miratohet dhe si komunikohet tek Komunitat.

1.2. A janë hartuar dhe dorëzuar tek komunat udhëzues dhe formularët për SMPK?

Kriteri: Udhëzuesi dhe formularët duhet të janë hartuar dhe miratuar nga autoritetet përkatëse brenda MAPL dhe duhet të jenë dorëzuar tek Komunitat pas miratimit.

1.3. A mbahen trajnime për zyrtarët përgjegjës për SMPK dhe a bëhen vlerësime se sa ato i janë përshtatur nevojave të zyrtarëve përgjegjës?

⁷ Dokument diskutimi, Performanca financiare dhe shërbimet e ofruara në komuna, 2014

Kriteri: MAPL duhet të hartojë një plan të trajnimeve për të gjithë zyrtarët e përfshirë në SMPK, në nivel të MAPL dhe nivel komunal. MAPL duhet të sigurohet se trajnimet e mbajtura janë kuptuar dhe kanë gjetur zbatim në praktikë. Paqartësitë/vështirësitë e hasura gjatë punës duhet të adresohen tek koordinatorët komunal, respektivisht nga koordinatorët komunal tek MAPL për të ofruar trajnime ose sqarime shtesë.

- 1.4. Të dhënat e dorëzuar nga komunat tek MAPL a kalojnë përmes një procesi të verifikimit, analizës dhe prezantimit?

Kriteri: MAPL duhet të formojë një komision i cili përbëhet nga MAPL, shoqëria civile dhe donatorët roli i të cilit është verifikimi i të dhënave të pranuar në bazë të së cilave ndahen fondet stimuluese. Procesi duhet të jetë i dokumentuar dhe t'i përfshijë të gjitha komunat.

2. A janë krijuar parakushtet e nevojshme nga komunat për të siguruar funksionimin e duhur të SMPK?

- 2.1. A janë vendosur politika të komunikimit/raportimit mes palëve të përfshira në proces dhe a po gjejnë zbatim në praktikë?

Kriteri: Kryetari duhet të ketë vendosur politika formale të komunikimit (qarkore) dhe t'i ketë komunikuar ato tek palët raportuese. Drejtorët e Drejtorive përkatëse komunale duhet të pranojnë informacione të rregullta nga palët e jashtme (p.sh. Ndërmarrjet Publike). Ato duhet të mbajnë evidence të veprimtarisë për të cilën janë përgjegjëse dhe rezultatet t'i komunikojnë tek zyrtarët komunal.

- 2.2. A janë caktuar personat përgjegjës për të siguruar mbarëvajtjen e funksionimit të SMPK?

Kriteri: Kryetari duhet të caktojë koordinatorin dhe zyrtarët përgjegjës për raportim.

- 2.3. A bëhet verifikimi i saktësisë së të dhënave në formularë?

Kriteri: Koordinatori komunal duhet të verifikojë se a janë të plotësuar formularët dhe sigurohet se informatat e prezantuara në formularë mbështetën në dokumente.

Kryetari i komunës para se të nënshkruaj formularët duhet të sigurohet se paraprakisht koordinatori komunal ka bërë verifikimin e të i të dhënave

1.4 Fushëveprimi i auditimit

Fushëveprimi i auditimit përfshin raportimin e komunave për vitin 2016.

Subjektet e audituara janë MAPL dhe gjashtë komuna.

Mostra prej gjashtë komunave është përzgjedhur bazuar në tri kritere. I pari është buxheti vjetor i komunës, kriteri i dytë është performanca e komunës në fushat e SMPK dhe i treti është kriteri etnik. Për t'i përzgjedhur mostrat sipas kriterit të buxhetit komunat i kemi ndarë në tri kategori; në kategorinë e parë hyjnë komunat që kanë buxhet vjetor mbi 10 milion euro, në të dytën prej 3 deri në 10 milion euro dhe në kategorinë e tretë hyjnë komunat që kanë buxhet vjetor nën 3 milion euro. Kështu janë përzgjedhur nga dy komuna nga secila kategori dhe nga secila kategori njëra komunë ka qenë përfituese e fondit stimulues.

Komunat e përzgjedhura janë: Peja dhe Ferizaj - të kategorisë së parë, Obiliqi dhe Graçanica - të kategorisë së dytë dhe, Juniku dhe Mamusha - të kategorisë së tretë sipas kriterit të buxhetit.

1.5 Metodologjia e auditimit

Pyetjeve të auditimi iu kemi përgjigjur duke u bazuar në teknika të ndryshme të mbledhjes së të dhënave siç janë: hulumtimet, pyetësorët, intervistat dhe studimi i dokumenteve relevante.

Pyetjeve të auditimit iu kemi përgjigjur duke:

- Vlerësuar nëse udhëzuesit e punës janë përpiluar qartë dhe komunikuar tek të gjithë përdoruesit;
- Analizuar formularët e plotësuar të SMPK për t'i krahasuar me burimin e të dhënave në të cilin janë mbështetur;
- Ekzaminuar kontrollet në të gjitha nivelet e raportimit për të parë se si janë aplikuar;
- Vlerësuar mënyrën se si koordinatorët komunal bëjnë verifikimin e të dhënave dhe nëse ato janë plotësuar përsëri pas vërejtjeve eventuale;
- Vlerësuar komunikimin (qarkullimin e informatave) nga ofruesit e shërbimeve të ndryshme jashtë komunës tek drejtoritë relevante komunale dhe nga to tek zyrtarët komunal;
- Intervistuar zyrtarët komunal për raportim, koordinatorët, kryetarët e komunës dhe me drejtoritë relevante si dhe përgjegjësitë për SMPK nga MAPL.

2 Përshkrimi i fushës së auditimit

Për të siguruar funksionimin e duhur të SMPK-së, parakushtet themelore janë: baza ligjore, vet sistemi dhe personat përgjegjës për zbatimin e tij.

2.1 Dokumentet relevante

Korniza aktuale e dokumenteve të cilat e rregullojnë këtë fushë janë:

- **Rregullorja nr. 02/2013**, për SMPK qëllimi i së cilës është matja dhe monitorimi i performancës së shërbimeve komunale të ofruara për qytetarët, sigurimi i qëndrueshmërisë së SMPK dhe ngritja e cilësisë së ofrimit të shërbimeve;
- Dokumenti i përgjithshëm i SMPK - i cili e përshkruan ndërtimin e përgjithshëm të sistemit. Ky dokument përshkruan në detaje secilën fushë, tregues, rezultat si dhe jep instruksione se nga duhet të merren të dhënat; dhe
- Udhëzimet e punës.

2.2 Përshkrimi i SMPK

Për arritjen e qëllimit të SMPK, janë zhvilluar objektivat e përgjithshme që janë të lidhura ngushtë me veprimet e MAPL, të komunave dhe palëve tjera kryesore të interesit. Objektivat tregojnë rrugën se si do të arrihet deri te qëllimet e SMPK. Objektivat themelore të SMPK janë:

- Zbatimi i metodologjisë standarde për matjen e performancës së komunave;
- Sigurimi i besueshmërisë së të dhënave;
- Publikimi i informatave të besueshme ; dhe
- Përmirësimi i procesit të vendimmarrjes dhe lehtësimi i veprimit të administratës komunale.

SMPK përbëhet nga:

Fushat - shprehin grupin e të drejtave (kompetencave) dhe të detyrimeve që komunat i ushtrojnë në shërbim të qytetarëve;

Rezultatet - janë arritje afatshkurtra apo afatgjata që komunat i synojnë në secilën fushë specifike që e ushtrojnë;

Treguesit - madhësi (në përgjithësi statistikore, por edhe logjike) që tregon se deri në çfarë shkalle janë arritur rezultatet; dhe

Të dhënat - janë fakte që dëshmojnë se një shërbim është përmbushur në masën dhe cilësinë e caktuar apo të kërkuar.

Në përgjithësi sistemi ka **14 fusha**,⁸ që mbulon 18 kompetenca vetanake të Komunave, **24 rezultate**, **65 tregues** dhe **203 të dhëna**.

Pjesë përbërëse e SMPK është edhe programi elektronik i cili mundëson raportimin e të dhënave nga komunat në mënyrë elektronike në MAPL.

2.3 Palët e përfshira dhe mënyra e përfshirjes së tyre në zbatimin e SMPK

Tre akterët e drejtpërdrejtë përgjegjës për funksionimin e sistemit në kuadër të komunës janë:

Zyrtarët për performancën komunale - zyrtarë të komunës të cilët merren me matjen, grumbullimin, raportimin dhe analizimin e treguesve të shërbimeve për fushat e caktuara.

Koordinatori për performancën komunale i cili kryen rolin e ndërlidhësit në mes të komunës gjegjëse dhe MAPL. Ai është bartësi kryesor i procesit të komunikimit dhe koordinimit të punës në mbledhjen, verifikimin dhe raportimin e të dhënave për sistemin e menaxhimit të performancës së komunës së vet.

Kryetari i komunës ka rolin kryesor në sigurimin e cilësisë dhe miratimin e të dhënave pas përfundimit të procesit të mbledhjes, përpunimit dhe verifikimit të tyre.

MAPL luan rol të veçantë në proces, si zhvillues dhe monitorues i implementimit të sistemit. Departamenti për performancë dhe transparencë komunale është përgjegjës, përveç tjerash,⁹ edhe për Zhvillimin dhe monitorimin e sistemit për vlerësimin e performancës së komunave.

Hapat kryesor që duhet ndjekur për regjistrimin e të dhënave në SMPK, sipas Udhëzuesit janë si në vijim:

1. MAPL dërgon njoftimin me pakon e dokumenteve (udhëzimet e punës dhe formularët) te koordinatori komunal;
2. Koordinatori komunal ofron udhëzime/sqarime për zyrtarët përgjegjës komunal dhe iu shpërndan udhëzimet e punës dhe formularët për secilin tregues sipas fushave përkatëse;
3. Zyrtari përgjegjës për fushën përkatëse e plotëson formularin me të dhënat e nevojshme për secilin tregues veç e veç. Zyrtari përgjegjës për fushën përkatëse është përgjegjës për kontrollimin e plotësisë së të dhënave për secilin tregues; verifikimin e saktësisë së të dhënave në dokumentacione, arkiva, faqe zyrtare të internetit etj; dhe dorëzimin e formularit me të dhëna tek Koordinatori;

⁸ Shërbimet publike administrative; të drejtat e njeriut, shërbimet sociale dhe familjare, kulturë rini dhe sport; menaxhimi i fatkeqësive; planifikimi hapësinor; hapësirat publike; infrastruktura rrugore; transporti publik; parkingjet publike; ujë i pijshëm; kanalizimi; mbeturinat; mbrojtja e mjedisit

⁹ Propozon, harton dhe siguron zbatimin e planeve për zhvillimin e kapaciteteve në komuna; Ofron mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit të kapaciteteve në komuna; Monitoron cilësinë e shërbimeve (performancën) komunale; Planifikon dhe bashkërendon veprimet për monitorimin e transparencës në qeverisjen lokale; Zhvillon kriteret për vlerësimin e transparencës komunale; etj.

4. Koordinator kontrollon plotësinë dhe saktësinë të dhënave, dhe në rast se konsideron se ndonjë e dhënë duhet të përmirësohet, kërkon nga zyrtari përgjegjës i cili ka raportuar të dhënë, ta përmirësojë. Kur koordinatori sigurohet se të dhënat janë të sakta, të gjithë formularët i dorëzon tek Kryetari i komunës për miratim;
5. Kryetari i komunës sigurohet për saktësinë e të dhënave dhe bënë miratimin e tyre pastaj i kthen tek Koordinatori, i cili raporton këto të dhëna në formë elektronike dhe fizike në MAPL; dhe
6. Pas përfundimit të fazës së mbledhjes dhe raportimit të të dhënave, MAPL organizon vizita në komuna për të bërë verifikimin e të dhënave sipas mostrave të përzgjedhura, me qëllim të hartimit të raportit të SMPK të rishikuar. Raporti përmbledhës publikohet në ueb faqen e Ministrisë. Pas vlerësimit të punës vjetore të komunave nga MAPL dhe donatorët ndahen fondet stimuluese në mbështetje të menaxhimit të performancës së shërbimeve komunale, për projektet komunale me prioritet.

3 Të gjeturat kyçe

Ky kapitull paraqet veprimet që janë ndërmarrë nga MAPL dhe komunat për të siguruar funksionimin e SMPK-së. Këtu janë prezantuar të gjeturat që kanë të bëjnë me veprimet ose mosveprimet e MAPL dhe komunave në raport kërkesat e SMPK-në.

3.1 Krijimi i parakushteve të nevojshme nga MAPL për të siguruar funksionimin e duhur të SMPK-së

Për të krijuar parakushtet e nevojshme për funksionim të duhur të SMPK-së, MAPL duhet ndërmarrë një sërë veprimesh.

1. Së pari duhet siguruar qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e sistemit duke azhurnuar rregulloren për SMPK sipas nevojës, dhe duke hartuar procedura të qarta që trajtojnë ndryshimet e mundshme në sistem;
2. Së dyti, udhëzimet e punës dhe formularët duhet hartuar me kohë dhe shpërndarë tek komunat;
3. Çështja e tretë që duhet siguruar është trajnimi i zyrtarëve komunal përgjegjës për raportim si dhe vlerësimi se sa ka qenë adekuat trajnimi i organizuar; dhe
4. Përfundimisht MAPL duhet të verifikojë dhe prezantojë të dhënat e raportuara nga Komunat.

3.1.1 Ndryshimet në SMPK - procedurat e nevojshme për të iniciuar ndryshimin, miratimin dhe komunikimin e ndryshimeve tek Komunat.

Rregullorja 02/2013 ishte rishikuar dhe hartimi i rregullores së re ishte në proces por nuk ishte miratuar edhe pse kishin ndodhur ndryshime në sistem. Sipas rregullores 02/2013, raportimi i të dhënave nga komunat bëhet dy herë gjatë vitit, deri me 15 korrik dhe pas përfundimit të vitit deri më 15 janar. Por sipas SMPK-së së rishikuar raportimi i të dhënave bëhet një herë në vit dhe afati i fundit për raportim është 15 shkurti i vitit vijues.

MAPL nuk kishte një procedurë lidhur me ndryshimet në sistem, për të përshkruar se si iniciohet ndryshimi dhe si procedohet më tutje deri në miratim dhe implementim të ndryshimit. Kjo është e nevojshme të hartohet dhe të respektohet me qëllim që komunat raportuese të njoftohen me kohë me ndryshimet për të qenë në gjendje të marrin masat e nevojshme për t'iu përgjigjur kërkesave të SMPK-së së ndryshuar. Megjithëse, procedura në fjalë nuk ekziston MAPL kishte komunikuar me komunat përmes postës elektronike për t'i njoftuar me përbërjen e SMPK-së së ndryshuar.

Gjithashtu, nuk kemi hasur në procedura adekuate që e rregullojnë funksionalizimin e Sistemit elektronik për menaxhim të performancës komunale i cili është parakusht për zbatimin e sistemit në mënyrë të pavarur dhe të pacenueshme (mungesë e politikave, procedurave dhe rregulloreve për zbatimin efektiv të SEMPK-së).

3.1.2 Hartimi dhe dorëzimi tek komunat i udhëzuesve dhe formularëve të SMPK

MAPL ishte kujdesur që me kohë t'ua vë në dispozicion udhëzimet e punës dhe formularët të gjitha komunave. Dy dokumente kryesore ishin hartuar dhe dorëzuar tek Koordinatorët komunal. Njëri dokument - Ndërtimi i përgjithshëm të sistemit – përshkruan sistemin në përgjithësi duke filluar nga konteksti i zhvillimit të SMPK-së, konceptet e sistemit, qëllimet dhe përshkrimin e secilit tregues të secilës fushë. Ndërsa dokumenti tjetër – Udhëzimet e punës –përbante udhëzime të hollësishme mbi hapat e nevojshëm për mbledhjen, verifikim dhe raportimin e të dhënave. Këto dy dokumente se bashku me formularët ishin dërguar me kohë tek të gjithë Koordinatorët komunal.

3.1.3 Trajnimi për zyrtarët përgjegjës për SMPK

MAPL, me mbështetje të DEMOS-it, kishte organizuar dhe mbajtur tri trajnime, dy për koordinatorët dhe njërin për ZPR-të. Trajnimi për koordinatorët kishte qenë pesë ditor dhe kishte mbuluar secilën fushë dhe tregues të SMPK. Në fund të trajnimit koordinatorët pjesëmarrës iu ishin nënshtruar një testi, kalueshmëria e të cilit kishte qenë në nivel të kënaqshëm. Mesatarisht koordinatorët kishin arritur 67 pikë prej 100 të mundshme. Për MAPL ky rezultat kishte qenë indikator se trajnimi ishte efektiv dhe se koordinatorët ishin të gatshëm të përcjellin njohuritë e fituara gjatë trajnimit tek ZPR-të përkatës.

Trajnimi i dytë ishte organizuar për ZPR-të e të gjitha komunave dhe kishte trajtuar secilën fushë dhe tregues të SMPK-së. Megjithatë ky trajnim, sipas intervistave me ZPR-të pjesëmarrës, nuk kishte qenë efektiv sepse një seancë e trajnimit kishte zgjatur rreth 1-2 orë për fushë ndërsa numri i pjesëmarrësve në seancë kishte qenë diku prej 25-30. Mësimi nuk kishte qenë interaktiv ku pjesëmarrësit do të kishin mundur të parashtronjë pyetje lidhur me shqetësimet ose paqartësitë potenciale lidhur me raportimin, por kishte qenë në formë të prezantimit.

Edhe një trajnim i tretë ishte mbajtur për koordinatorët mbi cilësinë e të dhënave dhe sigurimin e cilësisë së të dhënave. Sipas ligjëruesve trajnimi nuk kishte dhënë rezultatet e pritura sepse njohuritë e audiencës lidhur me temën e trajnimit ishin bazike prandaj nuk ishte arritur objektiva e trajnimit.

3.1.4 Procesi të verifikimit, analizës dhe prezantimit të të dhënave

MAPL kishte ndërmarrë disa veprime për të verifikuar saktësinë e të dhënave të raportuara nga komunat. Kishte bërë vizita ditore nëpër komuna duke kaluar nëpër formularët e plotësuar dhe duke këshilluar zyrtarët komunal se si t'i korrigjojnë gabimet, aty ku ishin gjetur. Me kapacitet aktuale MAPL kishte arritur të bëjë gjithsej 14 vizita të tilla brenda shtatë ditëve¹⁰. Këto ishin vizita të shkurtra dhe vetëm sipërfaqësisht kishin kaluar nëpër formularë.

Mënyra tjetër për verifikimin e saktësisë së të dhënave ishte përmes krahasimit të vlerave të raportuara në vitin aktual me ato të raportuara në vitin paraprak. Shfaqja e ndonjë difference të

¹⁰ 12 - 20 janar 2017

madhe mes tyre ishte indikator se e dhëna nuk ishte raportuar saktë. Në këso rastesh komuna përkatëse ishte këshilluar që të rishikojë të dhënën dhe eventualisht ta korrigjojë.

Mënyrë tjetër për verifikim të saktësisë së të dhënave ishte identifikimi i gabimeve logjike, p.sh. në rast se një e dhënë kërkohet të raportohet në dy ose më shumë tregues, atëherë duhet që e dhëna të jetë e njëjtë në të gjitha rastet. Ose kur vlera e një të dhënë është praktikisht e pamundur të jetë e vërtetë si p.sh. numri i të punësuarve në komunë të jetë shtatë, ose të ngjashme.

3.2 Krijimi i parakushteve të nevojshme nga Komunat për të siguruar funksionimin e duhur të SMPK-së

Për të krijuar parakushtet e nevojshme për funksionim të duhur të SMPK-së komuna duhet të ndërmerret veprimet në vijim:

1. Së pari, Kryetari i komunës duhet t'i caktojë personat përgjegjës për raportim. Zyrtarët komunal përgjegjës për raportim për SMPK janë përgjegjës kryesor për mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave nga burime të ndryshme brenda njësive organizative të komunës (drejtoritë komunale) dhe jashtë (ndërmarrjet publike);
2. Së dyti, duhet krijuar politika të komunikimit/raportimit mes njësive organizative të komunës, zyrtarëve raportues dhe koordinatorëve përgjegjës. Këto politika do të përfshinin një mënyrë formale të raportimit mes palëve të përfshira në proces; dhe
3. Së treti, të sigurohet se është verifikuar saktësia e të dhënave në formular. Koordinatori komunal për SMPK është përgjegjës për të verifikuar saktësinë e të dhënave të prezantuara në formularët e SMPK-së, duke u siguruar që të dhënat e raportuara janë të sakta dhe se janë bazuar në dokumente.

3.2.1 Caktimi i personave përgjegjës për të siguruar funksionimin e SMPK-së

Sipas udhëzuesit, kryetari i komunës duhet të caktojë koordinatorin dhe së paku katër raportues, varësisht prej madhësisë së komunës. Secili raportues i emëruar nga kryetari duhet të raportojë për fushën e caktuar. Kemi vërejtur se në komunën e Mamushës, Ferizajt dhe Obiliqit një numër i zyrtarëve nuk kishin raportuar fare dhe se kryetari nuk ka qenë fare i informuar për këto ndryshime.

Tabela 1. Paraqet numrin e ZRP-ve të cilët nuk kishin raportuar.

Komuna	Madhësia	Nr i ZRP-ve të caktuar	ZPR që s'kanë raportuar
Peja	E madhe	10	0
Ferizaj	E madhe	13	2
Obiliq	E mesme	7	1
Graçanicë	E mesme	9	0
Junik	E vogël	9	0
Mamushë	E vogël	6	3

Nga tabela më lartë shihet se gjashtë ZPR nuk kishin raportuar, prandaj në mungesë të tyre, ZPR tjerë ishin detyruar të raportojnë për fusha që nuk ishin përgjegjësi e tij/saj e as që kishin marrë trajnim adekuat për to. Komuna e Mamushës kishte raportuar me më pak zyrtarë se që parashihet me udhëzues.

Ishte gjetur edhe një rast¹¹ kur koordinatori ishte caktuar për të mbledhur dhe raportuar të dhënat në formularë. Kjo paraqet konflikt interesi sepse me këtë veprim është eliminuar një pikë e kontrollit në proces.

3.2.2 Politikat e komunikimit/raportimit mes palëve të përfshira në proces

Për të përforcuar bashkëpunimin dhe komunikimin mes palëve të përfshira në procesin e raportimit për SMPK, kryetari i komunës do të duhej të zhvillonte një komunikim me të gjitha njësitë organizative të komunës për t'i përgatitur ato për sigurimin e të dhënave duke lehtësuar kështu procesin e mbledhjes së të dhënave për ZPR-të.

Asnjë kryetar komune, që ishte subjekt i këtij auditimi, nuk e kishte shpërndarë një qarkore ose së paku një njoftim përmes postës elektronike për t'i njoftuar njësitë organizative të komunës lidhur me aktivitetin e paraparë të mbledhjes së të dhënave për SMPK.

Në mungesë të këtij komunikimi, ZPR-të, në disa raste, kishin hasur në vështirësi gjatë mbledhjes së të dhënave. Në bazë të intervistave të zhvilluara, në disa raste, stafi i njërive organizative të komunës nuk ishte në dispozicion për të siguruar informacionin që kërkohej nga ZPR-të.

Njësitë e ndryshme organizative të komunës kishin përgatitur raporte periodike të cilat përmbanin informacion të mjaftueshëm por jo në të gjitha rastet ishin shfrytëzuar si burim direkt i informacionit gjatë mbledhjes së të dhënave.

Burimet e informacionit për ZPR-të ishin të ndryshme. Disa prej ZPR-ve i kishin bazuar të dhënat e prezantuara në raportet periodike të njërive organizative të komunës, shumica i kishin bazuar të dhënat në shkresën që iu ishte dhënë nga njësi në bazë të kërkesës së ZPR për të dhëna specifike për treguesit. Kishte edhe ZPR që nuk e kishin bazuar të dhënën e tyre në asnjë burim (as njësi as dokument). Përveç kësaj kishte raste kur dokumenti i referuar nuk ishte relevant d.m.th e dhëna nuk gjendej në dokumentin e referuar.

Mënyra e mbledhjes së të dhënave kishte dalluar prej komunës në komunë si dhe brenda vet komunës. Për shembull një mënyrë e mbledhjes së të dhënave – mënyra e duhur – ishte që ZPR kishte kontaktuar përgjegjësit e drejtorisë përkatëse personalisht dhe kishte parë vet dokumentet të cilat ishin të nevojshme për të plotësuar të dhënën në formular. E dhëna ishte plotësuar e së bashku me të burimi përkatësisht drejtorja dhe dokumenti prej ku ishte marrë e dhëna.

Mënyrë tjetër e pranueshme ishte përgjigjja me shkresë zyrtare nga njësitë komunale e cila përmbante të dhënën si dhe referencën në burim e të dhënës. Pavarësisht se dokumenti referues

¹¹ Komuna e Obiliqit

nuk iu ishte bashkëngjitur formularit, ZPR kishte pasur mundësi të shihte dokumentin dhe të bindej se e dhëna është e saktë.

Dy mënyra tjera të mbledhjes së të dhënave – që nuk janë të pranueshme sepse nuk sigurojnë se e dhëna është e saktë – ishin përdorur shumë shpesh pothuaj në të gjitha komunat. Njëra mënyrë ishte përmes dërgimit të një kërkesë me shkrim në drejtorinë përkatëse ku specifikohet se çfarë të dhënash kërkohen. Përgjigja në kërkesë ishte kthyer megjithatë referenca në dokumentin burimor prej nga ishte marrë e dhëna mungonte. ZPR si burim të të dhënave kishte cekur drejtorinë përkatëse ndërsa dokument referues ishte pikërisht përgjigja me shkrim e drejtorisë.

Kishte raste kur ZPR nuk kishte bërë as shkresë por e kishte dërguar formularin tek njësia komunale dhe kishte kërkuar që njësia t'ia kthejë të plotësuar. Kjo formë e mbledhjes së të dhënave kishte ndodhur më së shpeshti në Ferizaj.

Mënyrë tjetër shumë më e rrallë e mbledhjes së të dhënave ishte komunikimi verbal. Pra kjo mënyrë e mbledhjes së të dhënave nuk ka bazë në asnjë dokument. Pjesërisht kjo kishte ndodhur sepse e dhëna e kërkuar nuk ishte dokumentuar nga asnjë njësi organizative e komunës por ishte e bazuar në dije të përgjithshme.

3.2.3 Verifikimi i saktësisë së të dhënave në formularë


Punën rreth mbledhjes dhe raportimit të të dhënave në formulare nga ZPR-të e kontrollon koordinatori për t'u siguruar se të dhënat janë të sakta. Procedura që ndiqet në këtë rast është që për secilën të dhënë të raportuar verifikohet vlera e raportuar dhe burimi prej nga ka ardhur.

Koordinatori komunal në Pejë, pjesën më të madhe të të dhënave e kishte verifikuar si duhet dhe kishte nënshkruar formularët vetëm pasi ishte siguruar se të dhënat ishin të sakta. Formularëve të plotësuar iu ishin bashkëngjitur dokumentet të cilave iu ishin referuar si burim i të dhënave, përveç në rastet kur dokumentet ishin voluminoze dhe s'kishte mundësi t'iu bashkëngjiteshin formularit.

Koordinatorët komunal kishin aplikuar këtë mënyrë të verifikimit të të dhënave në komunat Obiliç, Graçanicë dhe Junik përveç se dallimi me Pejë ishte se referenca në dokumente nuk ishte aq relevante sepse dokumenti të cilit iu kishin referuar në nuk e konsiderojmë si dokument relevant.

Koordinatori në Ferizaj nuk kishte ndjekur këtë procedurë të verifikimit të të dhënave, por në vend të kësaj kishte kërkuar një konfirmim me shkrim nga secila drejtori, që kishte furnizuar ZPR-të me të dhëna, se të dhënat janë të sakta.

Komuna e Mamushës nuk kishte raportuar me kohë prandaj procesi i verifikimit i të dhënave për shumë fusha nuk kishte ndodhur fare.

Grafiku 1. Përqindja e treguesve të mbështetur me dëshmi për gjashtë komunat e audituara.

Vetëm 51% e të dhënave të raportuara në gjashtë komunat e audituara janë mbështetur në dokumente, 32% nuk kishin mbështetje të mjaftueshme në dokumente, nëntë për qind e të dhënave nuk ishin të sakta dhe pesë për qind e treguesve nuk ishin raportuar fare (shih shtojcën 1). Me këtë shkallë të dokumentimit cenohet besueshmëria e raportimit prandaj komunat duhet të ndërmarrin veprime konkrete me qëllim të përmirësimit të kushteve për raportim për SMPK.

Tabela 2. Përmbledhja e treguesve në numër për gjashtë komunat e audituara.

	Ferizaj	Pejë	Obiliq	Graçanicë	Junik	Mamushë	Gjithsej	%
1 - e dhëna është mbështetur në dokument	12	44	44	20	47	29	196	51%
2 - e dhëna nuk është mbështetur në dokument	32	10	19	31	12	20	119	32%
3 - e dhëna nuk është e saktë	8	10	1	9	5	1	34	9%
0 - nuk është raportuar fare	3	0	0	4	0	14	21	5%
N/A ¹²	9	0	0	0	0	0	9	2%
Gjithsej ¹³	64	64	64	64	64	64	384	100%

¹² Nuk është e auditueshme për shkak se s'kemi pasur qasje në burimin e të dhënave (intraneti nuk ishte funksional).

¹³ Treguesi 1.1.3 - Koha mesatare e shqyrtimit të kërkesave për shërbimeve publike administrative- nuk është raportuar nga komunat pasi që sistemi i intranetit nuk e ofron këtë mundësi. Prandaj nga 65 tregues janë raportuar dhe audituar 64.

Tabela më lart tregon për numrin e treguesve dhe sa janë mbështetur me dëshmi në secilën nga gjashtë komunat e audituara. Mbështetja në dokumente për komunat e audituara është si në vijim: Ferizaj me 19%, Peja me 68%, Obiliqi me 68%, Graçanica me 31%, Juniku me 73% dhe Mamusha me 45%.

3.3 Më shumë detaje për secilën fushë të SMPK

Fusha 1: Shërbimet publike administrative

Kjo fushë përfshinë shërbimet publike administrative dhe menaxhimin e kërkesave të qytetarëve, personave fizik dhe juridik drejtuar organeve komunale për çështjet që lidhen me kompetencat e komunave dhe të cilat kalojnë nëpërmjet Qendrës për Shërbimin e Qytetarëve në Komunë.

Komuna Pejë, Ferizaj, Junik dhe Obiliq kishin raportuar të dhëna të sakta në këtë fushë. Burimi i të dhënave ishte intraneti i komunës.

Komuna e Graçanicës nuk e kishte në përdorim intranetin, as versionin e vjetër as të riun. Kërkesat e qytetarëve në komunë të Graçanicës gjendeshin në regjistra fizik prej ku ZPR i kishte marrë të dhënat.

Komuna e Mamushës nuk kishte raportuar për këtë fushë sepse nga janari 2017 kishte filluar të përdorë një version të ri të intranetit ndërsa në versionin e vjetër nuk kishte qasje. Komuna e Mamushës nuk i kishte ruajtur ose arkivuar të dhënat e intranetit të vjetër as në formë fizike as elektronike.

Intraneti i vjetër nuk e kishte mundësinë që kërkesat e pranuar nga qytetarët t'i kategorizojë sipas afateve ligjore (shtatë kategori, prej 1 ditë deri në 45 ditë), brenda të cilit komuna është e obliguar të adresojë kërkesën. Prandaj komunat nuk kishin raportuar numrin e kërkesave të pranuar në kategori të ndryshme. Treguesi 1.1.3 – Koha mesatare e shqyrtimit të kërkesave për shërbimeve publike administrative- nuk është raportuar nga komunat pasi që sistemi i intranetit nuk e ofron këtë mundësi. Prandaj nga 65 tregues janë raportuar dhe audituar 64.

Fusha 2: Transparenca

Transparenca komunale i referohet pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendim-marrjes në organet komunale. Ky proces përfshinë qasjen e qytetarëve në mbledhjet e Kuvendit Komunal dhe të Komisioneve të tij, mbledhjeve të institucioneve komunale me publikun, detyrimeve të komunave që të informojnë dhe konsultojnë publikun gjatë zhvillimit të akteve komunale. Në rastet kur komuna nuk mund të sigurojë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, ajo krijon mekanizma të përshtatshëm për t'i informuar ata për punën e organeve komunale, nëpërmjet qasjes në dokumente fizike publike, qasjes në dokumente elektronike në faqet zyrtare të komunës, në veçanti sigurimi i qasjes në planifikimin e buxhetit dhe shpenzimit të tij, si dhe qasjen që ka të bëjë me shfrytëzimin e pronës së paluajtshme në pronësi të komunës.

Transparenca komunale arrihet përmes publikimit të njoftimeve dhe dokumenteve të ndryshme kryesisht në ueb faqe të saj.

Ueb faqet në përgjithësi ishin të azhurnuara dhe të dhënat e raportuara ishin të bazuara në ueb faqe, por ajo kishte strukturë komplekse prandaj ishte e vështirë edhe për vet ZPR-të të gjejnë informatat të cilat i kishin raportuar për SMPK.

Komuna e Pejës për shkak të numri të madh të dokumenteve kishte vështirësi në postimin e dokumenteve në ueb sepse faqja kishte numër të kufizuar të hapësirës për postim. Për të postuar një dokument të ri duhej hequr një të mëhershëm.

Ueb faqja e Komunës së Ferizajt nuk ishte fare funksionale prandaj të dhënat e raportuara nuk ishte e mundur të auditohen.

Një prej të dhënave që me SMPK kërkohet të postohet në ueb faqe është plani i prokurimit për vitin përkatës. Mirëpo sipas formularit standard të planit të prokurimit, ky plan duhet të mbetet konfidencial ndërsa Ligji për prokurim publik nuk e trajton konfidencialitetin e planit. Prandaj asnjëra komunë nuk e kishte publikuar dhe si të tillë nuk e ka përmbushur kërkesën për raportim të këtij treguesi.

Të dhënat e raportuara për këtë fushë kryesisht ishin bazuar në dokumente me përjashtim të treguesit 2.2.6 - përmbushja e kriterëve të faqes zyrtare elektronike - ku mungonin disa elemente të cilat faqja zyrtare duhet t'i përmbajë.

Fusha 3: Të drejtat e njeriut dhe shërbimet sociale

Përmes kësaj fushe tentohet të matet barazia dhe mbrojtja nga diskriminimi i qytetarëve si dhe ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare për qytetarët në nevojë. Fusha përmban gjithsej shtatë tregues.

Katër nga gjashtë komunat e audituara i kishin raportuar saktë të dhënat për këtë fushë.

Komuna e Pejës dhe e Ferizajt nuk kishin raportuar saktë për treguesit 3.1.1 – përqindja e të punësuarve me aftësi të kufizuar në institucionet komunale, në baza gjinore deri 3.1.3 – përqindja e të punësuarve nga komunitetet jo-shumicë sipas përkatësisë gjinore sepse ZPR-të kishin nuk e kishin kuptuar drejtë se të punësuarit e cilave institucionet komunale duhet të raportohen. Për shkak të këtij keqkuptimi ishin raportuar vetëm të punësuarit që janë brenda objektit të komunës pa përfshirë edhe të punësuarit në Shëndetësi dhe Arsim.

Komuna e Junikut kishte raportuar vetëm të punësuarit që janë rekrutuar gjatë vitit raportues. Më vonë e kishte korrigjuar dhe ri-dorëzuar formularin në MAPL.

Treguesit 3.2.1 – përqindja e familjeve në nevojë të cilave iu është siguruar banimi deri 3.2.4 – përqindja e fëmijëve në nevojë me strehim familjar matin arrijen e komunës në ofrimin e shërbimeve të nevojshme sociale dhe për mbrojtjen e familjes përmes ofrimit të kushteve bazike për jetesë për qytetarët në nevojë (si banimi, mbrojtja e fëmijëve pa përkujdesje dhe ndihma sociale).

Të dhënat e raportuara për këta tregues janë siguruar nga Qendra për punë sociale dhe ishin të sakta në të gjitha komunat.

Fusha 4: Kultura, Rinia dhe Sporti

Kjo fushë e matë performancën e komunës në krijimin e parakushteve fizike (objekteve dhe hapësirave) për zhvillimin e veprimtarive sportive, kulturore dhe rinore dhe numrin e organizimeve dhe bashkë-organizimeve për zhvillimin e këtyre veprimtarive, si dhe numrin e pjesëmarrësve në këto veprimtari.

Për të raportuar për këtë fushë kërkohet që komuna të ketë plane të punës që do të krahasohen me raportet e punës në mënyrë që të përcaktohet realizimi i planit.

Në mungesë të planit komunat kishin raportuar të gjitha aktivitetet që ishin realizuar pavarësisht se ato nuk ishin planifikuar.

Mungesë të planit kishin katër nga gjashtë komunat e audituara. Plan kishte komuna e Junikut dhe e Ferizajt por në planin e Ferizajt nuk ishin përfshirë të gjitha aktivitetet që ishin zhvilluar dhe raportuar gjatë vitit në komunë (ishin planifikuar pesë aktivitete ndërsa ishin raportuar 1068 si të planifikuara).

Gjithashtu zyrtarët nuk kishin pasur të qartë dallimin mes Projektit dhe Veprimtarisë, dy terma që janë përdorur në formularë. Në shumicën e rasteve komunat kishin raportuar shifra identike në këta dy tregues.

Pjesëmarrja e qytetarëve në këto veprimtari është raportuar me vlera të përafërta sepse pjesëmarrja nuk është dokumentuar formalisht (me bileta, me ftesa etj).

Fusha 5: Menaxhimi i fatkeqësive

Matja e performancës në këtë fushë përfshinë mbrojtjen e njerëzve dhe të pasurisë së tyre private dhe publike, si: mbrojtja nga zjarret, tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, ortekët e bores, thatësitrat, shpërthimi i sëmundjeve infektive, shkatërrimet e digave dhe aksidentet e ndryshme ekologjike. Për këtë komunat duhet të hartojnë një plan në fillim të vitit realizimi i të cilit përcaktohet në fund përmes një raporti të punës të drejtorisë/drejtorive përkatëse përgjegjëse për implementimin e planit.

Komuna e Pejës, Junikut dhe e Obiliqit kishin plane të punës për menaxhimin e fatkeqësive si dhe raport të punës për punët e kryera. Por të dhënat e raportuara nuk ishin gjithmonë të bazuara në dokumente, ato kishin raportuar edhe aktivitete që nuk ishin paraparë në plan.

Komuna e Ferizajt, Mamushës dhe e Graçanicës nuk kishin plan as raport për menaxhimin e fatkeqësive.

Sa i përket intervenimeve në rastet e raportuara të emergjencës të gjitha komunat kishin raportuar të dhëna duke u mbështetur në raportet nga Njësitë Lokale të Zjarrfikësve.

Fusha 6: Planifikimi hapësinor

Planifikimi hapësinor nënkupton zhvillimin hapësinor komunal nëpërmjet instrumenteve të planifikimit hapësinor si: Plani Zhvillimor Komunal, Harta Zonale e Komunës dhe Planet Rregulluese të Hollësishme për të siguruar veprimtarinë e jetës institucionale dhe shoqërore në mënyrë të organizuar.

Kjo fushë kërkon që komunat të raportojnë se sa për qind e territorit të komunës është e rregulluar me plane zhvillimore ose harta zonale.

Komuna e Pejës dhe e Junikut i kishin mbështetur me dokumente vlerat e raportuara për këtë tregues, ndërsa komunat tjera nuk kanë ofruar dëshmi të mjaftueshme për të mbështetur të dhënat e raportuara. Komuna e Ferizajt dhe e Graçanicës si referencë kishte paraqitur konfirmimin e marrë nga Drejtoria përkatëse. Komuna e Obiliqit dhe Mamushës nuk kanë ofruar ndonjë dokument mbështetës për këtë tregues.

Për treguesit 6.2.1 – përqindja e kërkesave të miratuara për leje të ndërtimit deri 6.2.3 – përqindja e objekteve të reja me leje të ndërtimit ku Komuna e Pejës dhe e Junikut kishin raportuar dhe mbështetur vlerat e raportuara me dokumente. Komuna e Obiliqit vetëm pjesërisht ndërsa Komuna e Ferizajt nuk kishte ofruar ndonjë dokument referues.

Fusha 7: Hapësirat publike

Komunat janë kompetente për ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike. Hapësirat publike përfshijnë parqet, sheshet, hapësirat e gjelbra dhe ato rekreative.

Fusha kërkon që të raportohet për madhësinë e sipërfaqeve të shesheve dhe parqeve publike dhe sa mirëmbahen ato.

Komuna Pejës dhe e Junikut kishin hartuar një Plan për mirëmbajtjen e hapësirave publike në të cilin ishin identifikuar, përveç tjerash, edhe hapësirat publike dhe sipërfaqja e tyre. Vlerat e raportuara i kishte bazuar në këtë dokument.

Komuna e Ferizajt nuk ka ofruar asnjë dëshmi për të mbështetur vlerat e raportuara por iu është referuar dokumentit (deklaratës) së drejtorisë përkatëse për konfirmim të saktësinë së të dhënave. Graçanica gjithashtu kishte raportuar vlera bazuar në shkresën e marrë nga drejtoria përkatëse por nuk iu kishte referuar ndonjë dokumenti zyrtar ku identifikohen sipërfaqet e hapësirave publike.

Komuna e Obiliqit dhe e Mamushës gjithashtu nuk kishin dokument që mbështet vlerat e raportuara.

Fusha 8: Infrastruktura rrugore

Infrastruktura rrugore lokale nënkupton rrugët komunale dhe infrastrukturën përkatëse përcjellëse (trotuaret dhe ndriçimin publik) që janë nën kompetencën e komunës.

Kjo fushë kërkon që komunat të raportojnë se sa për qind e totalit të rrugëve në komunë janë të shtruara, sa prej tyre mirëmbahen, sa kanë trotuare, ndriçim publik dhe sinjalizim horizontal dhe vertikal. Gjatësia e rrugëve mund të matet përmes matjeve në teren ose përmes aplikacioneve të si Google Maps, GIS App, Geo-app apo të tjera.

Komuna së Pejës kishte përdorur aplikacionin GIS në të cilin i kishte regjistruar rrugët e komunës, gjatësinë dhe kushtet e saj, dhe këto të dhëna i kishte përdorur për raportim.

Në komunën Ferizajt, Obiliqit, Graçanicës, Mamushës dhe Junikut të dhënat janë raportuar duke u bazuar në listën së emërimit të rrugëve, por këto përmbanin vetëm gjatësinë e rrugëve. Të dhënat tjera të kërkuara nuk i përmbante lista.

Komuna e Junikut, nuk e ka bërë raportimin sipas kërkesës së udhëzuesit, ka llogaritje të rrugëve në metra dhe në kilometra por edhe këto të dhëna i ka marr përmes kërkesës së dërguara te departamenti përkatës dhe është kthyer përgjigja në mënyrë të njëjtë pa ndonjë dokument mbështetës.

Situata e ngjashme është edhe në komunën e Graçanicës të dhënat nuk janë mbështetur me ndonjë dokument përveç asaj me letër të protokolluar nga departamenti përkatës.

Sa i përket përqindjes së rrugëve lokale të mirëmbajtura, komunat kanë raportuar duke u bazuar në të dhënat e siguruar nga kompanitë e mirëmbajtjes së rrugëve brenda territorit të tyre dhe kontratave të nënshkuara përmes prokurimit. Komuna e Mamushës këto të dhëna i ka bazuar në kontrata mbi vepër të punëtorëve që këtë aktivitet e kryejnë për komunë. Por në kontrata nuk ceket emri dhe gjatësia e rrugëve të cilat mirëmbahen kështu që dokumenti të cilit iu ishin referuar nuk është i mjaftueshëm për të mbështetur të dhënat e raportuara.

Megjithatë raportimi nuk është bërë sipas kërkesës, komuna e Ferizajt ka raportuar të njëjtat të dhëna të gjatësisë së rrugëve në komuna dhe mirëmbajtja e tyre e tërësishme dhe nuk ka dëshmi që kjo ndodhë. Përderisa komuna e Graçanicës dhe Junikut janë mbështetur në të dhënat e ofruara përmes dokumentit të protokolluar i cili ka pas të dhënat e kërkuara por jo me ndonjë dokument mbështetës.

Komuna e Obiliqit këto të dhëna i ka marr nga raporti vjetor i punës në komunë.

Për ndriçim publik të rrugëve nuk ka asnjë të dhënë të plotë në komuna, përveç komunës së Pejës. Komuna e Obiliqit ka dëshmi për punën e kryer për ndriçim publik në komunë gjatë vitit raportues por nuk ka dëshmi për tërësinë.

Për rrugët me sistem të shënimit (të shenjzuar) komunat nuk kanë ofruar dëshmi për gjatësinë e plotë të rrugëve me shënjim edhe pse kanë prezantuar shifrat. Asnjë komunë nuk ka dëshmi nëse është punuar në këtë drejtim për të vlerësuar gjendjen e shënimit në territorin e tyre.

Fusha 9: Transporti publik

Transporti publik komunal (lokal) nënkupton ofrimin e transportit të qytetarëve, që me kushte të njëjta është i përshtatshëm për të gjithë shfrytëzuesit e shërbimeve të transportit në bazë të akteve normative të cilat i miraton komuna

Po ashtu komuna harton dhe aprovon planin e transportit rrugor lokal dhe e ndryshon atë sipas nevojës, varësisht nga rrethanat e krijuara, i cili nuk duhet të jetë në kundërshtim me rrjetin e linjave ndër-urbane të aprovuar dhe publikuar nga Ministria (Ligji për transportin rrugor, neni 6, paragrafi 2). Gjithashtu në përputhje me nenin 17, paragrafi 6 të Ligjit për Transportin Rrugor, komuna është e obliguar ta rregullojë me akt të veçantë komunal transportin e rregullt urban dhe urban-periferik të udhëtarëve me autobus, si transport i udhëtarëve në qarkullimin rrugor publik. Përpos kësaj, komuna ka kompetencë ekskluzive për licencimin e shërbimeve publike në fushën e transportit lokal publik, duke përfshirë edhe taksitë (Ligji për vetëqeverisjen lokale, neni 17).

Numri i veprimeve të planifikuara me planin komunal për transport lokal publik në raport me atë të realizuar. Shumica e komunave nuk i ka kuptuar kërkesat e formularit prandaj edhe raportimi nuk është bërë si duhet. Komuna e Graçanicës nuk ka raportuar fare për këtë indikator ndërsa komuna Pejës ka raportuar me zero. Gjatë takimit me zyrtarët kemi vërejtur që komunat aprovojnë kërkesa për transport publik dhe kanë plan për transportin që organizohet në territorin e tyre.

Raportimi për përqindjen e vendbanimeve të përfshira në transportin lokal publik është bërë bazuar në njohuritë e përgjithshme të zyrtarëve por nuk ka ndonjë dëshmi mbi saktësinë e këtyre të dhënave për shkak se nuk është kuptuar edhe kërkesa.

Gjithsej vendndalime të pajisura me shënjim për automjetet e transportit lokal publik. Komunat përveç Pejës me raportim zero dhe Graçanicës që nuk ka raportuar, nuk kanë dokumente mbështetëse për shënjëzimin të transportit lokal publik. Regjistrimi është bërë në bazë të njohurive të përgjithshme.

Fusha 10: Parkingjet Publike

Hapësirat për parkim publik janë vende në pronësi publike dhe private, me një numër të caktuar të vendeve të parkimit, të ndërtruara me standardet e kërkuara dhe të caktuara për parkimin e mjeteve motorike. Për qëllim të matjes së performancës në këtë fushë, termi “publik” në kontekst të parkingjeve, nuk i referohet pronësisë, dmth lokacionet apo parkingjet publike mund të jenë edhe në pronësi private dhe si të tilla të ofrojnë shërbime për publikun

Numri i përgjithshëm i parkingjeve publike në komunë përkatëse. Asnjë nga komunat e audituara nuk posedojnë dokumente mbështetëse për numrin e parkingjeve publike, përveç komunës së Pejës e cila ka vlerësuar gjendjen e parkingjeve dhe numrin e tyre por vetëm ato që janë në pronësi

publike, jo edhe parkingjet private. Për komunat tjera, numrat e shënuar janë bërë në bazë të njohurive të përgjithshme.

Numri i përgjithshëm i vend-parkimeve publike në komunën përkatëse nuk është i bazuar në ndonjë dokument, përveç rastit të komunës së Pejës e cila përmes komisionit ka identifikuar dhe numëruar vend-parkingjet publike në territorin e saj.

Numri i përgjithshëm i vend-parkimeve formale të destinuara vetëm për taksi . Të gjitha komunat kanë raportuar për numrin e parkingjeve në bazë të njohurive të përgjithshme. Nuk ka ndonjë regjistrim/dokument që dëshmon vend-parkingjet por as ato për taksi, përveç komunës së Mamushës që ka raportuar me zero.

Për numrin e përgjithshëm të parkingjeve me vend-parkime të rezervuara për persona me aftësi të kufizuar, komunat kanë raportuar por jo duke u bazuar në ndonjë dokument zyrtar. Raportimi është bërë duke u bazuar në njohuri të përgjithshme. Përveç komunës së Pejës e cila ka raportuar me zero duke u bazuar në atë që nuk ka njohuri apo dëshmi për këtë.

Fusha 11: Uji Pijshëm

Sigurimi apo furnizimi i qytetarëve me ujë të pijshëm është shërbimi më themelor që komuna përkatëse është e obliguar ta ofroj.

Të dhënat janë marr nga kompanitë e ujësjellësit rajonal apo komunal. Gjatë auditimit kemi vërejte vështirësi në komunikim në mes komunave dhe kompanive rajonale pasi që të dhënat në raportet e kompanive të ujit nuk janë të ndara sipas komunës. Komunat kanë arritur ti marrin të dhënat vetëm përmes komunikimit me ta duke i ofruar shifrat jo të dëshmuara sipas procesit të kërkuar në formular. Komuna e Graçanicës i ka marr të dhënat përmes telefonit ndërsa komuna e Ferizajt i ka dërguar formularët në kompani dhe ata i kanë plotësuar. Komunat nuk marrin informacion për mostrat e marra për testimin e cilësisë së ujit. Kërkesa është bërë nga komuna dhe është dorëzuar një raport i cili ka shërbyer si dëshmi për të plotësuar formularin.

Komuna e Mamushës nuk furnizohet me ujë të pijshëm prandaj edhe raportimi është bërë zero.

Fusha 12: Kanalizimi

Kjo fushë përfshinë konkretisht angazhimet e komunës dhe të kompanive përkatëse për menaxhimin e ujërave të zeza në ndërtimin e sistemit të kanalizimit, përfshirjen e të gjitha vendbanimeve dhe ekonomive familjare dhe biznesore në sistem, kontrollimin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshëm të sistemit të kanalizimit nga mbyllja dhe rrjedhja e tij jashtë, përcaktimin e tarifës për pagimin e shërbimit me mbledhjen e ujërave të zeza dhe shlyerjen e obligimeve nga qytetarët të cilët janë shfrytëzues të sistemit kanalizimit.

Komuna e Pejës shumicën e dëshmive ka siguruar brenda komunës, siç janë kontratat e punëve të ndryshme të kryera në këtë sferë.

Të gjitha të dhënat e raportuara në këtë fushë janë marrë nga kompanitë rajonale apo komunale të ujësjellësit. Në të gjitha rastet kompania e ujësjellësit është po ashtu edhe përgjegjëse për mirëmbajtjen e kanalizimit. Vështirësitë kanë qenë të njëjta për mënyrën e raportimit edhe pse kanë arritur të raportojnë duke u bazuar në të dhënat e siguruar nga këto kompani.

Fusha 13: Menaxhimi i mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave nënkupton aktivitetet e komunës për zvogëlimin e prodhimit të mbeturinave dhe veprimet përkatëse në grumbullimin dhe deponimin e tyre në vendet dhe mënyrat përkatëse të cilat sigurojnë mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit jetësor dhe të shëndetit të qytetarëve.

Kjo fushë përfshinë konkretisht angazhimet e komunës dhe të kompanive përkatëse në menaxhimin e procesit të mbledhjes nga të gjitha ekonomitë përkatëse që prodhojnë mbeturina, klasifikimin e tyre, transportin dhe deponimin e tyre në vendet e veçanta të ndërtuara në mënyrë specifike për deponimin e tyre në atë mënyrë që të zvogëlohet efekti i ndotjes së mjedisit dhe i shëndetit të qytetarëve.

Të dhënat janë të siguruar nga kompanitë rajonale apo komunale. Sikurse me kompanitë e ujësjellësit edhe këto raportojnë në baza tre, gjashtë dhe nëntë mujore dhe në fund dorëzojnë raport final. Sfidë mbetet edhe te këto kompani sigurimi i të dhënave sipas komunës. Të dhënat janë marr me kërkesë nga komuna. Sikurse me ujësjellës dhe kanalizim, edhe me mbeturina komuna e Ferizajt ka dorëzuar formularët te kompania për ti plotësuar por që nuk ka dëshmi për ti mbështetur të dhënat e ofruara.

Komuna e Mamushës ka të angazhuar punëtor për të kryer këto shërbime.

Gjithashtu në këtë rast kur të dhënat janë marr brenda komunës, ato janë bazuar në një dokument të protokolluar nga komuna por nuk ka dokumente mbështetëse për të vërtetuar saktësinë e të dhënave.

Fusha 14: Mbrojtja e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nënkupton veprimet e komunës përkatëse për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit natyror dhe jetësor (urban dhe rural) nga dëmtimi, degradimi apo ndotja si pasojë e veprimtarisë njerëzore ose të ndikimit natyror.

Mbrojtja e mjedisit përfshinë të gjitha veprimet të cilat janë të planifikuara me Planin e veprimit lokal në mjedis dhe programet mjedisore, i cili duhet të jetë në përputhje me Planin e Kosovës për veprim mjedisor (Ligji Nr. 03/L 025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 24), që ka të bëjë me mbrojtjen e të gjitha llojeve mjedisore nga të gjitha veprimet dhe materiet të cilat e rrezikojnë mjedisin në komunën përkatëse.

Komuna e Pejës si bazë për plan ka marr planin komunal mjedisor 2009-2015 edhe pse në bazë të intervistës me zyrtaren raportuese ato projekte ende nuk janë realizuar.

Komuna e Ferizajt nuk ka ndonjë dëshmi lidhur me raportimin për këtë fushë. Shifrat e paraqitura janë bërë pa ndonjë bazë.

Komuna e Mamushës nuk ka raportuar për këtë tregues.

Në përgjithësi raportimi nuk është bërë sipas kërkesës së treguesit pasi që është kërkuar të raportohet vetëm ato projekte që janë planifikuar ndërsa komunave iu mungon një plan i tillë.

Numri i Lejeve Mjedisore Komunale të lëshuara në vit në raport me lejet e ndërtimit të lëshuara në vit. Të dhënat për këtë tregues janë bazuar në të dhënat e marra nga departamenti i mjedisit por që të gjitha komunat nuk kanë marr dokumente të nevojshme për tu mbështetur përveç letrën e protokolluar dhe prezantimit të shifrave që janë realizuar.

Në rastin e komunës së Junikut ne kemi vërejtur që shifrat e paraqitura nuk kanë qenë në përputhje me numrin e raportuar.

Sipërfaqet e rregulluara mjedisore krahasohen me sipërfaqet e dëmtuara të mjedisit në komunë duke përfshirë edhe numrin e njerëzve dhe ditëve që janë angazhuar për të rregulluara sipërfaqet e dëmtuara të shprehura në hektarë.

Komunat nuk kishin ndonjë dokument në të cilin ishin identifikuar sipërfaqet e dëmtuara. Komunat në përgjithësi nuk kanë arritur të ofrojnë dëshmi mbi kërkesat e këtij tregues, përveç në komunën e Junikut e cila ka siguruar kontratat me kompanitë që janë angazhuar në këtë proces. Të gjitha të dhënat janë bazuar vetëm në shkresën e protokolluar po nuk ka ndonjë dëshmi mbështetëse.

4 Konkluzione

Përkundër progresit dhe masave të ndërmarra nga MAPL për krijimin e parakushteve për funksionimin e duhur të SMPK-së ende ka vend për përmirësim. Çështjet kryesore të cilat e cenojnë funksionimin e pritur të SMPK-së janë mos përditësimi i rregullores aktuale për t'iu përshtatur sistemit të ndryshuar dhe mungesa e një procedure për menaxhimin e ndryshimeve të mundshme në sistem në të ardhmen.

Nga ekzaminimi i dokumenteve në gjashtë komunat mostër, përkatësisht formularëve që shërbejnë për SMPK, mund të konstatojmë se komunat kanë vështirësi në aplikimin e procedurave dhe kontrolleve të parapara me sistem.

Analiza e dokumenteve të përdorura nga zyrtarët komunal për raportim të treguesve në gjashtë komunat a audituara ka rezultuar se vetëm 51% e treguesve gjejnë mbështetje në dokumente. Procedura e mbledhjes së të dhënave nuk ishte adekuate dhe kontrolli nga ana e koordinatorit nuk ishte efektiv. Kjo na sjell në përfundim se SMPK nuk është plotësisht efektiv.

4.1 Krijimi i parakushteve të nevojshme nga MAPL për të siguruar funksionimin e duhur të SMPK-së

SMPK aktual nuk kishte mbështetje adekuate në akt nënligjor (rregullore) si parakusht për efektivitetin e sistemit. Mos miratimi i rregullores së re nga MAPL e cila i përgjigjet SMPK-së aktuale rrezikon të shkaktojë paqartësi tek përdoruesit e sistemit, edhe pse udhëzuesi për shfrytëzimin e SMPK ishte hartuar në përputhshmëri me sistemin aktual dhe i njëjti ishte shpërndarë tek komunat.

Mungesa e një procedure që përshkruan procesin e menaxhimit të ndryshimeve në SMPK (për sistemin aktual edhe për të ardhmen) rrezikon efektivitetin e sistemit. Si pasojë në sistemin aktual është hasur një rast i pamundësisë së matjes së tregusit sepse bie ndesh me normat ekzistuese ligjore në vend.

Trajnimi i mbajtur për zyrtarët përgjegjës për raportim, rezulton se nuk ka qenë efektiv. Trajnimi prej dy orësh për fushë, me numër të madh pjesëmarrësish, e kishte pamundësuar komunikimin interaktiv mes trajnuesit dhe të trajnuarve. Përveç kësaj, mungesa e një testi/vlerësimi pas trajnimit ka sjellë për pasojë mungesën e feed-back-ut nga ana e të trajnuarve për njohuritë e marra.

MAPL nuk kishte ndërmarrë veprime për tu përgatitur për implementimin e SEMPK-së. Nuk ka përpiluar dhe miratuar dokumentacionin e nevojshëm -rregullore dhe procedura- për zbatimin efektiv të SEMPK-së. Kjo mund të sjellë pasoja në implementimin e pavarur dhe të pacenueshëm të sistemit.

4.2 Krijimi i parakushteve të nevojshme nga komunat për të siguruar funksionimin e duhur të SMPK-së

Kryetarët e komunave nuk kanë krijuar parakushtet e nevojshme për funksionimin e SMPK-së. Ata nuk kishin njoftuar njësitë organizative të komunës lidhur me obligimet që kanë për raportim për SMPK-në, prandaj jo të gjitha ishin përgatitur për të ofruar të dhëna. Kryetarët nuk ishin njoftuar me vështirësitë që zyrtarët përgjegjës për raportim kishin hasur gjatë kohës së raportimit, problemet rreth mbledhjes së të dhënave nuk ishin adresuar në nivel adekuat për t'u siguruar se të dhënat ishin mbështetur mjaftueshëm me dokumente.

Kontroli nga koordinatori komunal nuk kishte qenë efektiv. Të dhënat e raportuara që nuk kishin pasur mbështetje në dokumentacion nuk ishin identifikuar nga koordinatori në mënyrë që të kërkojë veprime korrigjuese.

Zyrtarët përgjegjës për raportim nuk e kishin kuptuar qartë procedurën e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave duke përdorur kështu procedura jo të duhura (në mospërputhshmëri me udhëzuesin) të mbledhjes së të dhënave.

Raportet periodike të njësive organizative të komunës ishin shfrytëzuar fare pak si burim i të dhënave sepse zyrtarët përgjegjës për raportim nuk ishin të informuar se ekzistojnë të tillët. Edhe në rastet kur ishin shfrytëzuar, ato nuk përmbanin informatat e nevojshme prandaj raportimi ishte i mangët. Mungesa e planeve mbi aktivitetet e komunës, në shumë raste, ishte faktor kontribues për raportim të mangët për SMPK.

Në mungesë të të dhënave të sakta lidhur me aktivitetet që ka zhvilluar, komuna nuk kishte mundësi të raportojë drejtë gjendjen në komunë. Komuna, qytetarët e hisedarët tjerë nuk do të kenë mundësi ta vlerësojnë performancën e komunës, a po i arrin objektivat e veta apo jo dhe a ka nevojë për përmirësime në shërbimet e komunës ndaj qytetarëve.

5 Rekomandimet

Ky kapitull përfshinë rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit për përmirësime praktike që lidhen me SMPK, bazuar në të gjeturat e auditimit dhe në konkluzione.

MAPL duhet të sigurohet që SMPK të jetë plotësisht funksional dhe operativ. Rregullorja e rishikuar duhet të miratohet dhe të futet në zbatim të plotë si përkrahje për SMPK.

Kryetari i komunës të sigurohet se të gjitha kushtet për një raportim efektiv për SMPK janë plotësuar.

Prandaj rekomandojmë MAPL që:

- Të miratojë rregulloren e rishikuar për SMPK aktuale;
- Të hartojë një procedurë për menaxhim të ndryshimeve të SMPK e cila do të specifikojë qartë se kush është përgjegjës për iniciimin, zhvillimin, aprovimin dhe zbatimin e ndryshimeve në sistem;
- Të hartojë dhe miratojë dokumentacionin – rregullore dhe procedurat - e nevojshëm për funksionalizimin dhe futjen në përdorim të SEMPK-së; dhe
- Të sigurojë ngritjen e kapaciteteve të ZPR-ve në mënyrë të vazhdueshme e posaçërisht në fushat ku janë identifikuar mangësi në raportim.

Rekomandojmë Kryetarët e Komunave që:

- Të hartojnë dhe dërgojnë një qarkore tek të gjitha njësitë organizative të komunës për t'i njoftuar lidhur me procesin e raportimit për SMPK në mënyrë që të jenë të përgatitura për të siguruar të dhënat e kërkuara për SMPK;
- Të sigurojnë bashkëpunim të ngushtë mes zyrtarëve përgjegjës për raportim dhe drejtorive komunale. Drejtoritë sapo t'i kenë të gatshme dhe të miratuara planet dhe raportet e punës t'ia vënë ato në dispozicion koordinatorit komunal e ky pastaj ZPR-ve përkatës; dhe
- Të sigurohen se koordinatori komunal dhe zyrtarët përgjegjës për raportim i kanë kuptuar drejtë procedurat e mbledhjes, raportimit dhe verifikimit të të dhënave.

Shtojca I: Tabela e treguesve

Tabela më poshtë praqet se si kanë raportuar komunat:

1 – e dhëna është mbështetur në dokument

2 – e dhëna nuk është mbështetur në dokument

3 – e dhëna nuk është e saktë

0 – nuk është raportuar fare

N/A – nuk është e auditueshme

Fusha	Rezultati	Fusha	Treguesi	Ferizaj	Pejë	Obiliq	Graçanicë	Junik	Mamushë
1	Ofrimi i shërbime administrative sipas kërkesave të qytetarëve	1.1.1	% e lëndëve të shqyrtuara gjatë vitit	1	1	1	1	1	0
		1.1.2	% e lëndëve të shqyrtuara brenda afateve ligjore	1	1	1	1	1	0
Fusha	Rezultati	Fusha	Treguesi						
2	Sigurimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendim-marrjes në komunë	2.1.1	% e mbledhjeve të kuvendit komunal të bëra publike për qytetarët	N/A	1	1	1	1	1
		2.1.2	% e akteve të miratuara në kuvendin komunal për të cilat është konsultuar publiku	N/A	1	1	1	1	1
		2.1.3	Konsultimi i publikut për miratimin e kornizës afatmesme dhe buxhetit komunal	N/A	1	1	2	1	1
	Është siguruar qasja e qytetarëve në dokumente publike	2.2.1	% e publikimit të akteve të miratuara në kuvendin komunal në faqen zyrtare të komunës	N/A	1	2	1	1	1
		2.2.2	% e publikimit të akteve të miratuara nga kryetari i komunës në faqen zyrtare të komunës	N/A	1	2	1	1	1
		2.2.3	% e publikimit të dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit	N/A	3	1	3	1	1
		2.2.4	% e publikimit të dokumenteve të prokurimit publik të komunës	N/A	3	3	3	3	2

		2.2.5	% e realizimit të kërkesave të qytetarëve për qasje në dokumente publike	N/A	1	1	1	1	1
		2.2.6	% e përmbushjes së kriterëve të faqes zyrtare elektronike të komunës	N/A	2	2	2	2	2
Fusha	Rezultati	Fusha	Treguesi						
3	Sigurimi i barazisë dhe mbrojtja nga diskriminimi	3.1.1	% e të punësuarve me aftësi të kufizuar në institucionet komunale, në baza gjinore	3	3	1	1	1	1
		3.1.2	% e të punësuarve sipas përkatësisë gjinore	3	3	1	1	1	0
		3.1.3	% e të punësuarve nga komunitetet jo-shumicë sipas përkatësisë gjinore	3	3	1	1	1	2
	Ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare	3.2.1	% e familjeve në nevojë të cilave iu është siguruar banimi	2	1	1	1	1	2
		3.2.2	% e popullatës e cila përfiton nga skema sociale	2	1	1	1	1	2
		3.2.3	% e ankesave të miratuara për skemën e ndihmës sociale	2	1	1	1	1	2
		3.2.4	% e fëmijëve në nevojë me strehim familjar	2	1	1	1	1	2
Fusha	Rezultati	Fusha	Treguesi						
4	Ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme për ushtrimin e veprimtarive kulturore, rinore dhe sportive	4.1.1	% e realizimit të planit komunal për krijimin e kapaciteteve për veprimtari kulturore, rinore dhe sportive	2	3	2	3	3	0
	Rritja e numrit të veprimtarive kulturore, rinore e sportive dhe e pjesëmarrjes së qytetarëve	4.2.1	% e realizimit të veprimtarive të planifikuara për kulturë, rini dhe sport	2	2	2	3	1	0
		4.2.2	% e pjesëmarrjes së qytetarëve sipas veprimtarive për kulturë, rini dhe sport	1	1	1	1	1	3
Fusha	Rezultati	Fusha	Treguesi						
5	Mbrojtja e qytetarëve dhe e pasurisë së tyre nga fatkeqësitë	5.1.1	% e realizimit të planit komunal për menaxhimin e fatkeqësive	2	3	1	3	1	0
		5.1.2	% e intervenimeve për mbrojtje nga fatkeqësitë	2	1	1	1	1	1

Fusha	Rezultati	Fusha	Treguesi						
6	Planifikim i qëndrueshëm komunal	6.1.1	% e territorit të komunës për të cilat ekzistojnë planet rregulluese	2	1	1	2	1	0
		6.2.1	% e kërkesave të miratuara për leje të ndërtimit	2	1	1	2	3	0
	Ndërtim i planifikuar komunal	6.2.2	% e ndërtesave të reja të inspektuara	2	1	1	2	1	0
		6.2.3	% e objekteve të reja me leje të ndërtimit	2	1	2	2	1	0
Fusha	Rezultati	Fusha	Treguesi						
7	Hapësirë publike e mjaftueshme për një mjedis të shëndetshëm	7.1.1	Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në m2 për kokë banor	3	1	1	2	1	2
		7.1.2	Sipërfaqja e shesheve publike në m2 për kokë banori	2	1	2	2	1	2
		7.1.3	% e sipërfaqeve të hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht	2	2	2	2	1	2
Fusha	Rezultati	Fusha	Treguesi						
8	Infrastruktura rrugore lokale e zgjeruar, e shtruar dhe e mirëmbajtur	8.1.1	% e rrugëve lokale të shtruara	3	1	2	2	3	2
		8.1.2	% e rrugëve lokale të mirëmbajtura	2	1	2	2	2	2
	Infrastruktura rrugore lokale e sigurt për qytetarët	8.2.1	% e gjatësisë së rrugëve lokale me trotuare	3	1	2	2	3	2
		8.2.2	% e gjatësisë së rrugëve lokale me ndriçim publik	3	1	2	2	2	2
		8.2.3	% e gjatësisë së rrugëve lokale të shenjzuara	3	1	2	2	2	2
Fusha	Rezultati	Fusha	Treguesi						
9	Ofrimi i transportit lokal publik për të gjitha vendbanimet e komunës	9.1.1	% e realizimit të planit komunal për transport lokal publik	2	2	1	0	1	1
		9.1.2	% e vendbanimeve të përfshira në transportin lokal publik	2	2	1	0	1	1
		9.1.3	% e vendndalimeve të shenjzuara për automjetet e transportit publik	2	2	2	0	2	2

Fusha	Rezultati	Fusha	Treguesi						
10	Krijimi i hapësirave të mjaftueshme për parkim të mjeteve motorike	10.1.1	Numri i parkingjeve për parkimin e mjete motorike	2	1	2	3	2	1
		10.1.2	Numri i vendparkimeve për mjete motorike në territorin e komunës	2	1	1	2	2	1
		10.1.3	% e vendparkimeve të destinuara për taksi	2	1	2	2	2	1
		10.1.4	% e parkingjeve me vendparkime të rezervuara për persona me aftësi të kufizuar	2	1	2	2	2	1
Fusha	Rezultati	Fusha	Treguesi						
11	Përfshirja e të gjithë qytetarëve në sistemin e ujit të pijshëm	11.1.1	% e realizimit të planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjes	1	1	1	3	2	1
		11.1.2	% e vendbanimeve të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm	1	1	1	2	1	1
		11.1.3	% e ekonomive të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm	1	1	1	2	?	1
	Furnizimi i qëndrueshëm me ujë të pijshëm	11.2.1	% e ditëve në vit me furnizim të pa ndërprerë me ujë të pijshëm	1	1	1	2	1	1
		11.2.2	% e faturimit të ujit të shpenzuar	1	1	1	2	1	1
		11.2.3	% e pagesave të ujit të faturuar	1	1	1	2	1	1
	Furnizimi i qytetarëve me ujë të pijshëm sipas standardeve	11.3.1	% e mostrave të ujit të cila i plotësojnë standardet e ujit të pijshëm	1	1	1	2	1	1
Fusha	Rezultati	Fusha	Treguesi						
12	Përfshirja e të gjithë qytetarëve në sistemin e kanalizimit	12.1.1	% e realizimit të planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit	2	1	1	2	2	1
		12.1.2	% e vendbanimeve të përfshira në sistemin e kanalizimit	2	1	1	2	1	2
		12.1.3	% e ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit	0	1	1	2	1	2

	Trajtimi i ujërave të zeza	12.2.1	% e realizimit të investimeve të planifikuar për trajtimin e ujërave të zeza	0	1	1	1	1	1
		12.2.2	% e vendbanimeve të përfshira në sistemin për trajtim të ujërave të zeza	0	1	1	3	1	1
Fusha	Rezultati	Fusha	Treguesi						
13	Përfshirja e të gjithë qytetarëve në sistemin e grumbullimit të mbeturinave	13.1.1	% e realizimit të planit komunal për menaxhimin e mbeturinave	2	2	2	2	1	1
		13.1.2	% e vendbanimeve të përfshira në sistemin e grumbullimit të mbeturinave	1	3	1	2	1	1
		13.1.3	% e ekonomive që kanë qasje në sistemin për grumbullimin e mbeturinave	1	3	1	2	1	2
	Ofrim i qëndrueshëm i mbledhjes së mbeturinave	13.2.1	% e realizimit të orarit për mbledhjen e mbeturinave në vit	2	1	1	3	1	2
		13.2.2	% e inkasimit të mjeteve për mbledhjen e mbeturinave	2	2	1	2	1	1
	Hedhja e mbeturinave	13.3.1	Sasia e deponimit të mbeturinave në kilogram për kokë banori në vit	2	2	1	1	1	1
Fusha	Rezultati	Fusha	Treguesi						
14	Krijimi i një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm	14.1.1	% e realizimit të planit të veprimit lokal në mjedis	2	3	1	2	2	0
		14.1.2	% e lejeve mjedisore komunale	2	1	1	1	1	0
		14.1.3	% e ndërtesave të reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale	2	1	1	1	1	0
		14.1.4	% e sipërfaqeve të rregulluara mjedisore	2	2	2	0	2	0